



Në mbështetje të nenit 145, paragrafi 2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4,21,22 të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189), neni 7 (pika 2.3 dhe 4) neni 15 (pika 1, 2 dhe 3) të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037), Udhëzimit Administrativ për Licencimin e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë (Nr. 25/2012), Udhëzimit Administrativ për Themelimin e Agjencisë së Akreditimit të Kosovës (Nr. 11/2004), Udhëzimit Administrativ mbi Kriteret dhe Procedurat për Akreditimin e Shkollave të Larta Profesionale dhe Shkollave të Larta Teknike në Republikën e Kosovës (Nr. 12/2009), dhe Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.02/2013), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë, në mbledhjen XXXII-të të mbajtur më 23.03.2015, mori:

V E N D I M

- I. Aprovohet kërkesa e Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë për njohje të akreditimit institucional dhe të programeve të studimit të dhënë nga Agjencia e Akreditimit EVALAG.

- II. Njohja e akreditimit bëhet për periudhën tre vjeçare 23.03.2015–31.01.2018 në nivel institucional dhe për këto programe të studimit:
 - Menaxhimi i Mjedisit dhe Bujqësisë (BA & Arsim i Lartë Profesional niveli V sipas KEK),
 - Shitje dhe Marketing Ndërkombëtar (BA),
 - Menaxhimi i Shërbimeve Publike (BA)
 - Administratë Publike (Arsim i Lartë Profesional niveli V sipas KEK)
 - Marketing dhe Menaxhment (Arsim i Lartë Profesional niveli V sipas KEK)

A r s y e t i m

Duke u bazuar në nenin 3, pika 1.16 të Ligjit mbi Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, dispozitat e tjera ligjore të cekura me sipër dhe vendimin për akreditim të Agjencisë së Akreditimit EVALAG, KSHC vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla juridike: Ndaj këtij vendimi lejohet kërkesa për rishqyrtim të vendimit sipas afatit të përcaktuar në Ligjin mbi Procedurën Administrative

Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij

Vendimi u dërgohet;

- Kolegjit Ndërkombëtar të Biznesit në Mitrovicë,
- MASHT-it,
- Arkivit të AKA-së



Dr.sc. Ferdije Zhushi Etemi

Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë